

Teksti integral i Marrëveshjes së nënshkruar në Konçul

Teksti integral i kësaj marrëveshje është si vijon:

P.C. Feith, Përfaqësuesi Personal i Sekretarit Gjeneral të NATO-së

1. Nënshkruarit pajtohen që pa kushte të respektojnë dhe të mbikëqyrin armëpushimin dhe do të përmbahen nga të gjitha aksionet ushtarake, dhunës dhe përdorimit të forcës kundër njëri tjetrit dhe forcave të tjerëve.

2. Nënshkruarit pranojnë të mbajnë autoritetin dhe kontrollin mbi të gjitha elementet e tyre të armatosura dhe forcave paramilitare, kudo që janë të vendosura dhe të pranojnë përgjegjësinë e plotë për veprimet e tyre.

3. Nënshkruarit njohin dhe mbikëqyrin shtesën protokollare të Konventës së Gjenevës, të 12 Gushtit 1949, lidhur me mbrojtjen e viktimave nga konfliktet jondërkombëtare.

4. Marrëveshja vlenë për të gjitha forcat e armatosura dhe paramilitare, duke përfshirë policinë e vendosur brenda apo afër kufijve të Zonës së Sigurisë, të cilat janë të definuara në Marrëveshjen Tekniko-Ushtarake dhe Rezolutën 1244 të KS të OKB-së.

5. Forcat e Armatosura nënkuptojnë të gjitha palët grupet dhe individët, të cilët e pranojnë autoritetin dhe komandën e nënshkruarëve duke përfshirë forcat e rregullta, forcat policore, grupet e civilëve të armatosur, paramilitarët, gardat kombëtare, milicinë, policinë kufitare, rezervistët ushtarak, policinë ushtarake, shërbimin e intelgjencës, ministrinë federale dhe serbe të Punëve të Brendshme, rebelimin special lokal dhe policinë antiterroriste si dhe të gjitha forcat jo të rregullta.

6. Kushtet e marrëveshjes do të hyjnë në fuqi pas këmbimit të kopjeve të nënshkruara, në prani të të Dërguarit të Posaqëm të Sekretarit të Përgjithshëm dhe do të jenë efektive prej orës 00.01, 13 mars 2001.

7. MODALITETET

a) Palët pajtohen të mbajnë dhe respektojnë armëpushimin, i cili përfshin të gjitha llojet e armatimit si dhe vendosjen e minave apo mjeteve të tjera të improvizuara eksplozive.

b) Palët pajtohen të ndërmarrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar sigurinë dhe lirinë e lëvizjes së cilitdo personel të komunitetit ndërkombëtarë në rajon.

c) Palët pajtohen të ruhen pozicionet e tanishme të forcave të tyre të armatosura, me përjashtim të armatimit të rëndë rreth Buajnocit, të cilat duhet të kthehen në kazerma, e jo të shfrytëzojnë armëpushimin për t'i ndryshuar pozicionet e veta.

8. KUFIZIMET

a) Palët pranojnë që KOMKFOR –i , në këtë fazë, ta ruaj autoritetin nën kushtet e Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake mbi Zonën Tokësore të Sigurisë dhe Zonën Ajrore të Sigurisë. Ata pranojnë KOMKFOR-in si autoritet të vetëm, i cili vendos nëse, dhe nën çfarë kushte, forcat e RFJ-së lejohen të kontrollojnë dhe kthehen gradualisht në Zonën Tokësore të Sigurisë. Nëse ai vendos të lejoi një rihyrje të tillë, zonat në të cilat forcat e RFJ-së mund të hyjnë, do të jenë të dedinuara gjeografikisht dhe një definicion e i tillë do t'i zëvendësoi referencat e mëparshme, të dhënë në këtë marrëveshje, mbi "lokacionet e tanishme". Në të gjitha aspektet e tjera, kushtet e dhëna do të vazhdojnë të vlejnjë.

b) Pas rihyrjes nga policia do të kërkohet të veprojë në mënyrë të paanshme dhe t'i zbatojë ligjet e RFJ-së /Serbisë, pa ndashmëri në baza etnike, fetare apo racore.

c) Asnjë kusht i kësaj marrëveshje nuk mund të interpretohet si diçka që anulon të drejtën për vetëmbrojtje. Vetëmbrojtja nënkupton përdorimin e asaj force të domosdoshme dhe proporcionale, për ta mbrojtur veten, apo të tjerët, nga një sulm, apo nga ndonjë sulm i mundshëm. Secili përdorim i forcës duhet të kufizohet në shkallën, intenzitetin dhe kohëzgjatjen e domosdoshme për vetëmbrojtje e jo më shumë. Hakëmarrja nuk është vetëmbrojtje dhe do të paraqes shkelejt e armëpushimit të Zonës Tokësore të Sigurisë. Kufizimit i shtohet edhe ky pasus:

Në lidhje me paragrafin 8 nën (a), këtu deklaroj se unë dhe komandantët e mi nuk pranojnë përgjegjësi mbi aksionet spontane të elementëve të shqiptarëve lokal në Sektorin C (Lindje), në Zonën Tokësore të Sigurisë.

Shefket Musli, Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së.

Dëshmoi, P.C. Feith, Përfaqësues Personal i Sekretarit Gjeneral të NATO-së .